

# RAPORT TEKNIK

**Objekti :** Mirembajtje objekte ndertimore ne NJ.V.K.SH,Shtëpitë Mimoza+Qendra Komunitare,Stomatologjia Spitali Psiquiatrik,L.Bakteorologjik – Shkoder për vitin 2023

## 1. **Godina e Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor - Shkoder**

- a) Godina e Nj.V.K.Sh është ndertese **3 (tre) kate me solete dhe çati .**
- b) Siperfaqja e një kati **S = 520 m<sup>2</sup> . 3 (Tre) kate sipërfaqja S = 1560 m<sup>2</sup>**
- c) Pershkrimi teknik i godines:

**Godina e Nj.V.K. Shendetesor - Shkoder** gjendet ne lagjen “Naim Gjylbegu” Shkoder.Kjo ndertese eshte ndertuar ne vitet 1979-1980.

Objekti eshte ndertese tre kate me nderkate beton/armeje dhe e mbuluar me solete betoni + çati.Muret kryesore jane mure tulle 38 cm si ne katin perdhe ashtu dhe ne katin e pare.Lartesia e kateve eshte  $h = 3.06$  m .Siperfaqja e nje katit eshte 517 m<sup>2</sup>.Objekti ka oborr perpara dhe prapa.

Duke pare trashesine e mureve 38 cm mendojme se objekti nga ana konstruktive eshte i qendrueshem , megjithese ka nje amortizim 35 vjeçar.

Kesaj godine i eshte bere shtese kati i trete dhe rikonstruktuar ne vitin 2008.Te gjithë ambjentet e laboratorit Kimiko-Toksikologjik jane rikonstruktuar.

Kati i pare ne pergjithesi eshte i rikonstruktuar dhe ne gjendje te mire teknike (dyert dhe dritaret jane duralumini per te gjithë katin).Ky kat ka dy pjese ate te zyrave te administrates dhe pjesen e laboratorit kimiko – toksikologjik. Dyshemeja eshte e shtruar me pllaka te cilat jane ne kushte te mira teknike Pjesa ku jane te vendosura zyrat e administrates eshte ne gjendje te mire teknike.Keto ambjente jane te paisur me banake prej betonit te veshur me pllaka majolike.Ne keto ambjente duhet te kryhen punimet e meposhtme:

Sovatimi pjesor i murit. Te behet vendosja e pllakave te dyshemes ne veranden e daljes ne oborrin prapa gadines se D.R.Sh dhe batiskopeve ne ambjentet e domosdoshme ne pershtatje me pllaken e shtreses.

Shkalla mermeri ne veranden e daljes ne oborrin pas godines me trashesi  $d=3$ cm te davancialit dhe  $d=2$ cm vertikale balloret.

Meqenese do te spostohet pompa e ujit ne oborrin pas godines seD.RSh pasi gjendet ne ambjent te pa pershtateshme poshte shkalles.eshte e domosdoshme mbulimi i saj me mbulesë metalike + punime ndertimore.

Te behet zevendesimi i xhamave (akull,te tejdukshem dhe te tejdukshem dopjo) ne ambjentet ku do te kete thyerje te tyre.

## 2. **4 (Kater) Shtepite Mimoza**

- a) 4 (kater) Godinat e Shtëpive Mimoza janë ndertesa **2 (dy) kateshe me soletë b/a.**
- b) Siperfaqja e nje kati për **4 (kater) Shtëpitë Mimoza është S = 690 m<sup>2</sup> . 2 (dy) kate sipërfaqja është S = 1380 m<sup>2</sup> .**
- c) Pershkrimi teknik i godinës:

**4 (Kater) Shtepite Mimoza** jane ndertuar ne oborrin e ish Spitalit Civil dhe kane nje periudhe pese vjeçare qe funksionojne. Megjithate keto shtepi kane nevojë per mirembajtje ndertimore. Ne keto punime mund te permendim riparimet e ndryshme si; keqje, riparime sovati, heqje pllaka majolike+shtrese. Heqje pllaka dushi dhe kryerja e hidroizolimit si dhe vendosjen perseri te pjates se dushit. Heqjen e tubave xingato dhe vendosja e tubave plastic ku do te jete e domosdoshme riparimi i tyre. Shtëpitë Mimoza kanë shkarkimin e ujit ne pjesen e pasme te tyre ku duhet te behet ndertimi i nje pusete dhe hapja e kanalit te shkarkimit per ne puseten kryesore me tubacion plastik pvc  $\varnothing$  110 mm. Gjithashtu duhet te behet betonimi i trotuari si dhe vendosja e pllakave te betonit ku kryhet mbulimi i kanalit.

Mendojmë se është e domosdoshme lysterja pjesore me bojë plastike e tre Shtëpive Mimoza dhe lysterjet me ngjyrë sipas asaj egzistuese e ambjenteve të brendëshme ku është e nevojshme.

Duhet bere riparimi i grilave plastike te dritareve ku eshte e domosdoshme.

### 3. **Qendra Komunitare**

a) Reparti i Qendres Komunitare gjendet ne **katin e pare të Poliklinikës së Qytetit**.

b) Sipërfaqja e Qendres Komunitare është **S = 165 m<sup>2</sup>** .

c) Pershkrimi teknik.

**Qendra Komunitare** gjndet ne katin e pare te poliklinikes ne qender te qytetit Shkoder. Ambjentet e kesaj qendre jane te rikonstruara dhe ne gjendje te mire teknike. Problemi kryesor i kesaj qendre dhe qe kerkon nje nderhyrje te domosdoshme eshte lysterja e dhomave dhe te koridorit, meqenese ka rrethe 5 vjet qe eshte kryer nderhyrja per rikonstruksion dhe qe nga ajo kohe nuk eshte investuar.

### 4. **Repartit të Stomatologjisë**

a) Reparti i Stomatologjisë gjendet ne **katin e trete te Poliklinikës së Qytetit**.

b) Siperfaqja e saj është **S = 294 m<sup>2</sup>** .

c) Përshkrimi teknik.

**Reparti i stomatologjise** gjendet ne godinen e poliklinikes se qytetit ne katin e trete te saj ( kati i dyte teknik ). Ambjentet e ketij reparti jane te rikonstruara dhe ne gjendje te mire teknike. Problemi kryesore qe kerkon nje nderhyrje te domosdoshme eshte banjoja e cila funksionon por duhen riparime te vogla sovati dhe lysterje. Gjithashtu ne koridor ka lageshtire ne tavan e cila vjen nga tarraca per arsye se hidro/izolimi eshte i amortizuar pjeserisht. Prandaj duhet te behet h/izolimi pjesor me emulsion bitum dhe 2kk i tarraces se korridor rreth 15 m<sup>2</sup>.

### 5. **Godina e Spitali Psikiatrik**

a) Godina e Spitali Psikiatrik është ndërtesë **2 (dy) kate me soletë b/a** .

b) Sipërfaqja e një kati është **S = 851 m<sup>2</sup>**. **2 (kate) sipërfaqja është S = 1702m<sup>2</sup>**

c) Pershkrimi teknik i godinës:

**Spitali Psikiatrik** gjendet ne zonen Spitalore te qytetit. Godina e Spitalit Psikiatrik eshte ndertese 2 (dy) kateshe e mbuluar me solete. Ambjentet e ketyre

reparteve jane ne gjendeje shum te mire teknike, meqenese godina e Spitalit Psikiatrik eshte ndertuar ne vitin 2011. Mendojme se godina e Spitalit Psikiatrik duhet te mirembahet nga ana ndertimore. Ne nderhyrjet kryesore mendojme se jane: Riparimi i pikimeve ne banjo duke hequr, izoluar me material izolues te pllakave te dusheve. Lyerje te disa ambjenteve te domosdoshme. Zevendesimi i disa xhamave te thyer (xhama akull,te tejdukshem dhe te tejdukshem dopjo). Ku shikohet e domosdoshme duhet te behet riparimi i bravave te dyerve dhe te dritareve, vendosje menteshash, riparimi dorezave, riparime dyer-dritare duralumini etj.

Ne dy ballkonet anesore duhet te behet veshje e kornizes me llamarine xingato, vendosje ulluqe vertikale. Duhet te behet H/Izolimi me emulsion dhe 2 kk e parapetit te tarraces pjesa ballore. Magazine duhet te hidro/izolohet me emulsion bitumi dhe 2 kk, meqenese soleta ne periudhen me reshje pikon dhe rrezikohen materialet e buta qe gjenden ne kete ambjent.

#### 6. **Godina e Labororit Bakteriologjik**

a) Godina Labororit Bakteriologjik është ndërtesë **2 (dy) kate me çati** .

b) Siperfaqja e një kati është **S = 298 m<sup>2</sup>.2(dy)kate sipërfaqja është S = 596 m<sup>2</sup>**

c) Pershkrimi teknik i godinës :

**Ndertesa e Labororit Bakteriologjik** eshte nje objekt 2 (dy) katesh qe perbehet nga dy repartee ate te Labororit dhe te Pranimit. Siperfaqja totale e godines se Labororit Bakteriologjik eshte **S=596 m<sup>2</sup>** . Mendojme se eshte e domosdoshme nderhytja per riparime te pjesshme ndertimore ku perfshihen: Riparime te pjeseshme te sovotimeve ne lavanderin e labororit, shtrimin me pllaka te pjeses nen shkalla si aneks i lavanderis.Lyerje te ketij ambjenti me boje hidromat.Patinimi muri allçi (stuko) h=1.8 m i koridorit te ketij Laboratori. Ne banjon e katit te dyte duhet te behet veshja me pllaka majolike mbi lavaman. Te behet zevendesimi i xhamave (xham akull,xham i tejdukshem dhe xham i tejdukshem dopjo) ne dritaret dhe dyert ku jane te thyer. Duhet te behet riparimi i dorezave dhe bravave te dyerve dhe dritareve duralumini ku eshte e domosdoshme. Lyerje me boje hidromat i disa ambjenteve ku eshte e domosdoshme.

Ne menyre qe te kemi nje laborator me kushte sa me te mire dhe optimale per kryerjen e analizave sa me te sakta dhe ne kushte higjenike te pershtatshme. Gjithashtu dhe persaoneli mjeksor te punoje ne kushte normale pune dhe higjeno-sanitare.

Për NJ.V.K.Sh - Shkoder

Ing. Shkelzen Geci

Ek. Qamile Kakini

Tek. Shkelzen Vorfa